European Policy Institute. Skopje • Институт за европска политика - Скопје • Instituti për politikë evropiane - Shkup

**REKOMANDIM I NGRIRË**

# Analizë e Raportit të Komisionit Evropian për progresin e Republikës së Maqedonisë për vitin 2015

**11 nëntor 2015**

**Kryeredaktore:**

Dr. Malinka Ristevska-Jordanova, drejtoreshë dhe kryeredaktore e analizës

**Autorë:**

Dr. Simonida Kacarska, Koordinatore për hulumtim

Mr. Aleksandar Jovanoski, koordinator i Programit për demokraci dhe sundimin e së drejtës

Mr. Ardita Abazi-Imeri, koordinatore e Programit për acquis dhe politikat sektoriale

Mr. Elena Ançevska, hulumtuese

Leposava Ognjanoska, bashkëpunëtore

Angel Mojsovski, bashkëpunëtor

Mr. Iva Conevska, bashkëpunëtore

## Përmbajtja

Rekomandim me hap prapa dhe i kushtëzuar ........ 4
Raporti gjatë krizës më të thellë politike që nga viti 2001 ........ 5
Qasje e vjetër - e re me kritika dhe rekomandime më të drejtëpërdrejta........ 5
Regres dhe hendek më i thellë mes legjislacionit dhe realitetit ........ 6
Thirrje për përmbatjet e bisedave të përgjuara........ 7
Vlerësimet kyçe........ 7
Kriteret politike: kthimi në bazat ........ 7
Kriteriumet ekonomike ........ 12
Aftësia për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit ........ 13
Krahasimi me vitin 2014 në drejtim të progresit dhe harmonizimit ........ 14
Shtojca 1: Struktura e kritereve politike në raportin për vitin 2015........ 15
Shtojca 2: Shqyrtimi i rekomandimeve të kritereve politike për vitin 2015-2016........ 16
Shtojca 3: Përmbledhje e përfundimeve dhe vlerësimeve në kriteret politike 2011-2015........ 18
Shtojca 4: Shqyrtimi i konkluzioneve dhe vlerësimeve në kriteret ekonomike në periudhën vjetore 2013-2015 ........ 42
Shtojca 5: Pasqyra e konkluzioneve dhe vlerësimeve lidhur me përmbushjen e detyrimeve për vitet 2010-2015 ........ 49

## Rekomandim me hap prapa dhe i kushtëzuar

Rekomandimi për fillimin e negociatave për anëtarësim në BE në raportin e progresit të Republikës së Maqedonisë nga viti 2015 është i ngrirë dhe i kushtëzuar me: përmbushjen e plotë të marrëveshjes politike të muajit qershor/korrik 2015 dhe të prioriteteve urgjente të reformave, më së voni deri në mbajtjen e zgjedhjeve në prill të vitit 2016.

*Rekomandimi për fillimin e negociatave për anëtarësim në BE për Republikën e Maqedonisë është i ngrirë dhe i ksuhtëzuar me: zbatimi i plotë i marrëveshjes politike dhe prioritett urgjente të reformave, deri në mbajtjen e zgjedhjeve në prill të vitit 2016.*

Në Strategjinë për zgjerim të vitit 2015, Komisioni ka konkluduar:

***"Duke patur parasysh progresin e deritanishëm në zbatimin e marrëveshjes politike të nga qershori/korriku, Komisioni është i gatshëm ta japë rekomandimin e tij për hapjen e negociatave të anëtarësimit me Republiën e Maqedonisë. Megjithatë, kushti për këtë është zbatimi i vazhdueshëm i marrëveshjes politike nga muaji qershor/korrik dhe progresi i rrëndësishëm në zbatimin e prioriteteve urgjente të reformave. Kjo çështje do të shqyrtohet edhe një herë pas zgjedhjeve."***

Është e qartë që Komisioni aftësisht e paketuar dhe kushtëzuar rekomandimin, duke i patur parasysh edhe zhvillimet politike dhe debatet në vend. Është arritur një kompromis mes kritikave dhe nevojave për të nxitur reformat. Ashtu si çdoherë, ekziston hapësirë për interpretime të ndryshme nga ana e aktorëve politikë. Rreth agjendës së reformave e me qëllim të shmangies së interpretimeve të ndryshme lidhur me atë që do ndiqet në 6 muajt që vijojnv, në konferencën për shtyp, Komisioneri Hahn, theksoi që "nuk mund të bëhet gjithçka, por mund të bëhet shumë dhe ajo do të vlerësohet". Edhe kjo përgjegje nuk jep një pasqyrë të qartë dhe lë hapësirë për interpretime të ndryshme.

**Megjithatë, në formatin në të cilin është i dhënë, rekomandimi nuk do të jetë subjekt i shqyrtimit në mbledhjet e Këshillit të Ministrave në dhjetor të vitit 2015, sepse pritet zbatimi i kushteve të mësipërme gjer në prill të vitit 2016.**

Duke e patur parasysh të lartëpërmendurën, **konsiderojmë <u>që Republika e Maqedonisë aktualisht nuk ka rekomandim për fillimin e negociatave për anëtarësim</u>, ndërsa e njëjta mund të rirtrihet nëse zbatohet marrëveshja e Përzhino-s dhe prioritetet urgjente të reformave deri në zgjedhjet në prill 2016.**[1]

[1] Këtë e konfirmoi Komisioneri Hahn, në konferencën për shtyp të mbajtur më 10.11.2015, kur deklaroi që Komisioni është i përgatitur që sërish të ofrojë një rekomandim të plotë pas muajit Prill 2016, nëse ka progres.

## Raporti gjatë krizës më të thellë politike që nga viti 2001

Komisioni potencoi që Republika e Maqedonisë është në krizën më të rrëndë politike që nga viti 2001, dhe që pas publikimit të bisedave të përgjuara, ekzistojnë akuza për shkelje të të drejtave themelore, mbi lirinë e mediave dhe zgjedhjeve, si dhe ndërhyrje në pavarësinë e gjyqësorit, politizim dhe korrupsion në shumë fusha.

*Qeveria e Maqedonisë, Kuvendi dhe organet mbikëqyrëse nuk kanë reaguar në mënyrë adekuate mbi gjetjet e publikimit të bisedave të përgjuara*

Mes tjerash, vlerësohet që Qeveria e Maqedonisë, Kuvendi dhe organet relevante për mbikëqyrje nuk kanë reaguar në formë të duhur. Komisioni potencon që në vend të ndryshimeve ligjore, janë të nevojshme sanksione ligjore dhe masa politike për trajtimin të gjetjeve nga përgjimet.

Komisioni në kuadër të kriteriumeve politike shtron cështjen e **mbikëqyrjes mbi shërbimet e inteligjencës,** për të cilën veç më ka lajmëruar në raportin e vitit 2014 (shihni shtojcën Kriteret Politike). Sido që të jetë, referenca për mbikëqyrje mbi shërbimet e armatosura dhe të inteligjencës në kuadër të kriteriumeve politike zakonisht ishte në fazat e mëhershme të anëtarësimit dhe shënon një hap prapa në pjekurinë demokratike të një shoqërie.

## Qasje e vjetër - e re me kritika dhe rekmandime më të drejtëpërdrejta

Me Strategjinë për zgjerim të vitit 2015, Komisioni Evropian fillon me përgatitjen e qasjes së re mbi përgatitjen e raporteve të progresit për vendet që janë të përfshira në procesin e zgjerimit. Për të gjitha vendet që marrin pjesë Komisioni përcaktoi fusha kyçe që janë objekt i monitorimit shtesë**: sundimi i së drejtës dhe të drejtat themelore (duke përfshirë funksionimin e sistemit gjyqësor, korrupsionit, krimit të organizuar dhe lirisë së shprehjes), kriteret ekonomike, reformat për administratën publike, si dhe tre kapituj që janë të ndërlidhur: prokurimi publik, statistika dhe kontrolli financiar.**

Këto fusha e ndjekin parimin e miratuar vitin e klauar të njohur si **"bazat në fillim"(fundamentals first)** me qëllim që të tregohen rezultate reale në kapitujt kryesorë (K.23: Gjygjësori dhe të drejtat themelore, K.24:Drejtësia, liria dhe siguria, qeverisja ekonomike dhe refroma e administratës publike).Në të gjitha ata, aplikohet qasje e hollësishme e vlerësimit të situatës përmes analizave në kuadër ligjore dhe institucionale, si dhe rezultateve. **Sheqëtësues është fakti që pikërisht në këto fusha kyçe Maqedonia ngecën dhe/ose pëson regres, ashtu siç është e përshkruar më poshtë.**

Stili i ri i shkrimit të raporteve siguron transparencë më të madhe në vetë procesin e anëtarësimit. Shtetit i mundësohet që në formë më të qartë ta perceptojë situatën aktuale në drejtim të përgatitjeve për përmbushjen e kritereve për anëtarësim. Ajo që është më karakteristike për këtë raport është përfshirja e raportimit të harmonizuar dhe shkalla e vlerësimit në pesë nivele për progresin që është bërë brenda 12 muajve të fundit dhe nivelit të përgatitjes.[2]

---

[2] Më parë shfrytëzoheshin vlerësime të ndryshme - shihni shtojcën.

Termat që shfrytëzohen për progresin e arritur janë: zbrapsje, nuk ka progres, progres i caktuar, progres i mirë, progres shumë i mirë.

Termat që shfrytëzohen për nivelin e përputhshmërisë janë: faza e hershme, niveli i caktuar i përgatitjes, niveli relativ i përgatitjes, niveli i mirë i përgatitjes dhe niveli i avancuar.

**Megjithatë, metodologjia e Komisionit dhe metoda e vlerësimit nuk ndryshojnë shumë nga praktika e deritanishme. Respektivisht, Komisioni përpiqet të shfrytëzojë një terminologji të njëtrajtshme, edhe pse procesi dhe mekanizmat pas saj qëndrojnë të njëjta. EPI, analizat e saja brenda viteve të fundit i ka bazuar mbi terminologji të njëjtë përmes shkallëzimit të vlerësimeve në kapitujt. Ajo na mundësoi që edhe analizën aktuale ta zbatojmë sipas metodologjisë së njëjtë, si dhe të sigurojmë krahasueshmëri me vlerësimet e viteve të fundit.**[3]

Edhe përkundër asaj që përshtypja e parë është që metodologjia e re e KE-së mundëson dukshmëri dhe qartësi më të madhe, në analizën tonë fillestare vërrejtëm disa mospërputhje specifike. Zgjedhja e pilot zonave dhe çka është rëndësia e tyre duhet të jetë subjekt e të nënshtrohet në analiza plotësuese.

## Regres dhe hendek më i thellë mes legjislacionit dhe realitetit

Megjithatë, qasja e re e Komisionit këtë vit është me sukses më të madh i ilustron dallimet mes legjislacionit mirë të harmonizuar dhe situatës reale në vendet që aspirojnë anëtarësim. Me qasjen e re Komisioni përpiqet t'i tejkalojë kritikat shumëvjeçare të vlerësimit formal të progresit duke u drejtuar kah gjendja reale.

Në rastin e Republikës së Maqedonisë, në këtë raport është shumë i theksuar hendeku mes nivelit të mirë të përputhshmërisë legjislative (duke marrë në konsideratë marrëdhëniet me BE-në) dhe regresit në kriteret kyçe politike dhe ekonomike. Niveli i tyre i përputhshmërisë ashtu siç shënon EPI në raportet e tyre viteve të kaluara, është korrekte, duke patur parasysh që Republika e Maqedonisë e filloi harmonizimimin me legjislacionin evropian shumë më herët se vendet e tjera në rajon.

*Komisioni identifikon regres në sistemin gjyqësor, në lirinë e të shprehurit dhe në menaxhimin me financat publike (disiplina fiskale)*

Në anën tjetër, në këtë raport, Komisioni shumë më lirshëm dhe më shpesh e shfrytëzon termin regres, e cila është e identifikuar në fusha kyçe, të atilla si: **sistemi gjyqësor, liria e shprehjes dhe menaxhimi me financat publike (disiplina fiskale)**[4]

---

[3] Shihni raportet e mëparshme të EPI-t:
Analiza fillestare e Raportit të Komisionit Evropian për progresin e Republikës së Maqedonisë për vitin 2013, në dispozicion:
http://epi.org.mk/docs/prvicna_analiza_na_izvestajot_na_ek_za_napredokot_na_rm_za_2013.pdf
Rekomandim në hije, Analizë e Raportit të Komisionit Evropian për progresin e Republikës së Maqedonisë për vitin 2014
http://epi.org.mk/docs/Preporaka%20vo%20senka_Analiza%20na%20Izvestajot%20na%20EK%20za%20napredokot%20na%20RM%20za%202014.pdf
Rekomandimi i njëjtë, Porosi e re Raporti i Komisionit Evropian për progresin e Republikës së Maqedonisë për vitin 2012
http://epi.org.mk/docs/analiza_-_zakluchoci_-_ocenki_po_kriteriumi_i_poglavja_pr_2012_mk_commentary_%D0%9C%D0%9A.pdf

[4] Për krahasim, shtetet që aderojnë në BE, zbrapsja(regresi) është përmendur në: raportin e Turqisë (prokurimi publik, liria e shprehjes dhe liria e shoqërimit), Bosnja në 2 fusha (liria e shprehjes dhe Shoqëria Informatike dhe Mediat), dhe Shqipëria - në fushën e prokurimeve publike. Në raportet e Malit të Zi, Serbia dhe Kosova nuk ka konstatuar regres.

### Thirrje për përmbatjet e bisedave të përgjuara

Komisioni në këtë raport shumëherë në mënyrë direkte i referohet përmbajtjes së bisedave të përgjuara që shfaqin probleme sistematike mbi sundimin e së drejtës, si dhe përfshirja e disa zyrtarëve të lartë qeveritar (shihni pjesën vlerësimet kryesore: kriteret politike). Komisioni i referohet përmbajtjes së bisedave në kuadër të parregullsive zgjedore, (pa)varësisë së gjyqësorit, politizimit të administratës publike, ndikimit të mediave dhe luftës kundër korrupsionit e krimit të organizuar.

*Komisioni i referohet përmbajtjeve të bisedave të publikuara nga "bombat"*

## Vlerësimet kyçe

Në këtë pjesë të analizës pasqyrojmë vlerësimet kyçe. **Rishikimi i rekomandimeve, është i dhënë në Shtojcën 2.**

### Kriteret politike: kthimi në bazat

Sipas metodologjisë së modifikuar, kriteret politike janë ndryshuar sipas strukturave dhe në ato janë kthyer përmbajtje të cilat më herët kanë qenë të shpërndara në kapitujt 23 dhe 24 (tani përsëriten). Kryesisht, nuk ka dallime të mëdha. Në aspekt metodologjik, te vitet e kaluara përdorej vlerësim përshkrues për progresin e realizuar në vend, por këtë vit KE i ktheu terminet e standardizuara (progres i vogël, progres i moderuar, progresë etj.) për fusha specifike, veçanërisht në qeverisje, shoqëri civile, gjyqësorit, luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Jo rastësisht, ata janë në lidhje të ngushtë me

Struktura e modifikuar e kritereve politike është e paraqitur në shtojcën1.

Raporti thellësisht hyn në skanimin e situatës politike në Republikën e Maqedonisë, veçanërisht në kontekstin e marrëveshjes politike mes katër partive më të mëdha politike dhe prioriteteve urgjente të reformave (PUR).

Përmbajtja e materialeve të përgjimeve të publikuara (intercepted materials) shfrytëzohet si burim i informacioneve për përcaktim të gjendjeve të caktuara.

Gjetjet e raportit të Priebe-s, janë tërësisht të valorizuara dhe të përfshirë në këtë raport.

KE konstaton se deri në përfundimin e raportit, s'janë zbatuar të gjitha elementet e marrëveshjes politike, dhe që një numër i madh i afateve janë tejkaluar. Është vlerësuar që **realizimi i prioriteteve urgjente të reformave ka filluar ngadalë dhe deri në fund të raportit nuk ka rezultate të kënaqshme.**

***2.1 Demokracia***

Është përsëritur vlerësimi i vitit të kaluar për kulturën përçarëse politike, mungesën e kompromisit dhe dialogut të keqësuar, por tashmë konstatohet se ajo veç më është në formë të krizës së vazhdueshme dhe afatgjate politike - e vlerësuar si më e rrënda pas vitit 2001. "Kriza në Republikën e Maqedonisë u thelluar me publikimin e bisedave të përgjuara, të cilat përfshijnë zyrtarë të lartë në Qeveri dhe funksionerë të lartë partiak që shfaqin shkelje të së drejtave themelore, ndikim mbi pavarësinë e gjyqësorit, lirinë e mediave dhe zgjedhjeve, politizim dhe korrupsion në fusha të ndryshme"

KE potencon që ka paralajmëruar shqetësim për të gjitha këto çështje në raportet e kaluara të progresit.

- Është përmendur që përmbajtja e komunikimit të përgjuar i ka konfirmuar problemet lidhur me **zgjedhjet**, parapraksisht të vërtetuara nga OSBE/ODIHR dhe dyshimeve të tjera.

- KE sugjeron që kriza aktuale ka bërë të dukshme nevojën e **Parlamentit** që në mënyrë të konsiderueshme ta përmisojë rolin e saj si forum për dialog konstruktiv, politik, përfaqësi dhe funksionin e saj mbikëqyrës. I referohet mëkambjes së mbikëqyrjes së besueshme funksionale mbi punën e shërbimeve të inteligjencës dhe kapacitetit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në vend. Mungesa e partisë kryesore opozitare në periudhën raportuese e **zvogëlon kualitetin e reformave dhe e pengon sistemin e kontrollit dhe baraspeshës (checks and balances)**

***Në pjesën që më parë emërohej "qeveria", ndërsa tani quhet "qeverisje"*** *dominon thirrja për përgjegjshmëri politike. Sipas KE-së, "qeverisja" në vend është e tensionuar si pasojë e krizës aktuale politike dhe është vënë në pikëpyetje pas zbulimit të sjelljeve joetike, aktiviteteve joligjore madje edhe akteve potenciale kriminale." Dorëheqjet e deritanishme të dy ministrave dhe drejtorit të Shërbimit Sekret të Maqedonisë-së - në mënyrë të dukshme konsiderohen si të pamjaftueshme - konstatohet që është paraqitur vetëm "përgjegjësi e kufizuar politike".*

- KE rekomandon themelimin e mbikëqyrjes mbi organet kryesore (të gjithë rregullatorët e pavarur, organet mbikëqyrëse dhe këshilluese që duhet të jenë në gjendje t'i kryejnë funksionet e tyre në mënyrë proaktive, efektive dhe të pavarur nga presionet politike).
- Tensionet ndër-etnike nënvizojnë nevojën për zbatimin e plotë të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit. KE vazhdon t'i sheh marrëdhëniet ndëretnike si të brishta ndërsa rrethana që vështirësojnë të njëjtën janë edhe zhvillimet në Kumanovë dhe Goshince.
- Edhe pse në këto zhvillimet e fundit opinioni kryesisht nuk sheh incident ndëretnik, e për këtë edhe shumica e liderëve politikë bënë thirrje që të njëjtat mos të shihen si incident ndëretnik, mbetet që këta zhvillime hollësisht të hulumtohen, në mënyrë transparente e cila do të kontribuojë në përforcimin e besimit ndëretnik.
- Edhe pse natyra ndëretnike e strukturës së partive politike të përfshira në proceset kyçe politike dhe marrëveshjeve është në drejtim të mirëmbajtjes së marrëdhënieve ndëretnike, sërish ka mosbesim dhe tensione, tejkalimi i së cilës kërkon masa shtesë.
- Këtë vit, KE konstaton progres të caktuar në zhvillimin e **shoqërisë civile** dhe shpreh shqetësim serioz për mjedisin e vështirë në të cilin ata veprojnë. Në jehonën e krizës politike, mirëpritet roli konstruktiv përmes organizimit të protestave të shumta paqësore dhe unitetit mbi-etnik pas zhvillimeve tragjike në Kumanovë, pranverën e vitit 2015. KE konsideron se ekziston polarizim politik dhe shpërndarje mes organizatave qeveritare që e mbështesin Qeverinë dhe atyre të janë kritike ndaj saj.

– ***Mbikëqyrja e shërbimeve sekrete është vlerësuar si jo-funksional.*** Nuk është marrë përgjegjësi e mjaftueshme për lëshimet serioze në shërbimet e inteligjencës për parandalimin e përgjimit joligjor. Në këtë pjesë duhet të realizohen rekomandimet e i prioriteteve urgjente të reformave.

### *2.2 Reforma e Administratës Publike*

KE vlerëson që Republika e Maqedonisë në shkallë të moderuar është e përgatitur me reformën e Administratës Publike. Është zhvilluar progres i caktuar në legjislacionin dhe përmisimin e ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve dhe bizneseve. Edhe kjo pjesë i referohet përmbajtjes së materialeve të përgjuara që janë publikuar, ndërsa ndërlidhet edhe me vonesën e zbatimit të plotë të kuadrit të ri ligjor. Përsëritet deklarata e famshme, që është i nevojshëm një vullnet i fortë politik për garantimin e pavarësisë së administratës dhe respektimit të parimeve të transparencës, meritës dhe përfaqësimit të barabartë.

### *2.3 Sundimi i së* **drejtës**

**Gjyqësori** është një nga zonat më kritike, ku qartë është përcaktuar "regresi". Potencohet që në numër të madh të "rasteve të zakonshme" gjykatat mund të gjykojnë në mënyrë të pavarur, por ekziston edhe ndërhyrje politike kur bëhet fjalë për raste të ndjeshme politike, respektivisht raste të profileve të larta, që "hedh hije mbi tërë sistemin gjyqësor, i cili përndryshe është funksional". **Ndërhyrja e tillë politike ngrit dyshimin edhe mbi reformat tashmë veç më të zbatuara.** Ekzistenca e "drejtësisë selektive" ndërlidhet me dyshimin në funksionimin e sistemit elektronik për shpërndarje të rasteve. Në aspektin buxhetor, shuma e përgjithshme e fondeve për banorë është më e ulët se mesatarja evropiane, teksa numri i gjyqtarëve për banorë është më e lartë.

Vendi është në **një nivel të caktuar të gatishmërisë**, por **nuk ekziston progres në luftën kundër korrupsionit** që mbetet tejet e përhapur. Gjendja e këtillë ndërlidhet me mungesën e vullnetit politik dhe ndërhyrjen politike që e rrezikon aftësinë e autoriteteve të veprojnë në mënyrë të pavarur dhe autonome. Bisedat e përgjuara që janë publikuar kanë ngritur akuza serioze kundrejt zyrtarëve të lartë të qeverisë për keqpërdorim të detyrës dhe korrupsion. Posaçërisht shqetësuese është "pasiviteti selektiv", respektivisht indiferenca e organeve për zbatimin e ligjit, duke përfshirë edhe Prokurorinë Publike për t'i hetuar këto zbulime, me çka vihet në pyetje pavarësia e tyre.

**Ndërhyrja politike në suaza të rasteve të ndjeshme politike respektivisht të rasteve të profilit të lartë "hedh hije mbi tërë sistemin gjyqësor që përndryshe është funksional" dhe në mënyrë të qartë shënon "regres".**

**Nuk ka progres** as në **luftën kundër krimit të organizuar,** edhe pse këtu ekziston **një nivel i caktuar i gatishmërisë**. Lufta kundër krimit të organizuar është pjesë e Kapitullit 24, por në këtë raport sërish është e përmendur edhe në kriteret politike. Sipas KE-së, bisedat e përgjuara zbuluan mangësi serioze në zbatimin praktik të ligjeve në fushën e ndjekjes së përgjimeve të bisedave.

**Posaçërisht shqetësues është "pasiviteti selektiv", respektivisht indiferenca e organeve për zbatimin e ligjit, duke përfshirë edhe Prokurorinë Publike për t'i hetuar këto zbulime, me çka vihet në pyetje pavarësia e tyre.**

Mungesa e një mbikëqyrjeje të pavarur, eksterne dhe transparente mbi policinë lë hapësirë për akuza të vazhdueshme për politizim.

Në këtë raport theksohet edhe **lufta kundër terrorizmit** për shkak të fenomenit të shfaqjes së luftëtarëve të huaj dhe radikalizmit terrorist, si pasojë e së cilës potencohet nevoja për një strategji gjithëpërfshirëse dhe efektive.

### 2.4 Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e pakicave

– - KE **shënoi regres në lirinë e të shprehurit.** Në tri raste, KE i referohet bisedave të përgjuara për ta potencuar kontrollën e qeverisë mbi mediat. Gazetarët janë subjekt i presioneve, kërcënimeve dhe autocenzurës. Pavarësisht kornizës ligjore, shprehet shqetësim për pavarësinë politike të Agjencisë për audio dhe shërbime audio-vizuale dhe rolin e MTV-së si shërbim publik. Indikacionet janë që ka ndërhyrje politike në politikat editoriale, si dhe që ka lidhje të ngushta mes qeverisë dhe pronarëve kryesorë të shumicës së mediave që marrin pjesë më të madhe të fondeve nga fushatat qeveritare. KE liston Sitel-in, Kanal5, Alfa, MTV si televisione pro-qeveritare të orientuara me qasje selektive gjatë raportimit. Konkluzioni i përgjithshëm është që liria e shprehjes mbetet një sfidë serioze.
– **Komuniteti LGBT** akoma më tej është subjekt i diskriminimit dhe përmbajtjvee homofobike në media. Shqetësues është fakti që akoma asnjë nga sulmet nuk është hetuar plotësisht dhe autorët e krimit nuk janë gjetur.
– Situata e **komunitetit rom** mbetet kritike. Pavarësisht strategjisë së miratuar, pothuajse asnjë progres nuk ka në aspekt të përfaqësimit politik, përdorim të gjuhës rome në media, dhe statusit të gjuhës rome në komunat ku shumica e popullsisë janë rome.
– **Marrëveshja Kornizë e Ohrit** vazhdon të sigurojë bazë për marrëdhënie ndërmjet komuniteteve. Akoma ekzistojnë forma të shumta të diskriminimit ndaj pjesëtarëve të bashkësive jo-shumicë teksa aktivitetet për të luftuar stereotipet, duke i përfshirë edhe mediumet mbesin joefikase. KE e vë në dukje edhe bashkëpunimin e dobët ndërinstitucional dhe e kritikon faktin që masat sistematike janë kryesisht të financuara nga donatorë, ndërsa masat kundër segregacionit në shkolla janë të pamjaftueshme.
–

### 2.5 Çështjet rajonale dhe obligimet ndërkombëtare

Është përsëritur konkluzioni i mirënjohur që Maqedonia merr pjesë në mënyrë aktive në iniciativa rajonale dhe vazhdon të luajë një rol përgjithësisht konstruktiv në marrëdhëniet bilaterale me vendet e tjera që aspirojnë të anëtarësohen në BE dhe me shtetet anëtare fqinje të BE-së. Inkurajim të posaçshëm jep bashkëpunimi rajonal në kuadër të procesit të Berlinit, me vendet e Ballkanit Perëndimor (WB6) për intensifikimin e bashkëpunimit mes tyre dhe BE-së.

Karakteristike është që këtë vit, **çështjes së emrit i është kushtuar vëmendje jashtëzakonisht e vogël në krahasim me vitet e kaluara.** Përmbajtjet e tjera të kritereve politike kanë primat të plotë.

Marrëdhëniet me Bullgarinë edhe më tej janë nën ndikimin e çështjeve të hapura, kryesisht mbi të gjitha janë dallimet në "interpretimin e historisë", por nuk e pengojnë bashkëpunimin në fusha të tjera si dhe në marrëdhëniet e përditshme ndërpersonale.

**Çështja e emrit e lërë në prapavijë - deri tani i është kushtuar vëmendja më e vogël në raportin e KE-së.**

**Lidhur me kontestin për emrin me Greqinë, është thelbësore që të merren hapa vendimtare për zgjedhjen e kësaj çështje.** [5]

Edhe pse munguan biseda zyrtare, Ministri për Punë të Jashtme të Greqisë e vizitoi vendin për herë të parë pas 11 viteve dhe të dy palët ranë dakord mbi një numër masash për të ndërtuar besim reciprok.

***Përmbledhja e vlerësimeve kyçe, krahasuar me periudhën 2011-2015 është dhënë në Shtojcën 3.***

[5] EU enlargement strategy 2015, Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the regions, 10 November 2014, COM (2015) 611 final, faqe. 14

## Kriteret ekonomike

Përgatitja e Maqedonisë për zhvillimin e ekonomisë funksionale të tregut është e vlerësuar si e mirë, edhe pse këtë vit (në krahasim me vitet e kaluara) **nuk është spikatur progres.** Më tej, Komisioni vlerëson që ekonomia e Maqedonisë është *"pjesërisht e përgatitur për tu përballuar me presionet konkurruese dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian".*

*Këtë vit, Komisioni identifikon regres në disiplinën fiskale dhe menaxhimin e financave publike, veçanërisht në transparencë.*

**Përfundimi i KE-së që nuk ka progres në kriteret ekonomike është në formë të drejtëpërdrejtë në kundërshtim me pikëpamjet e Qeverisë në suksesin e ekonomisë.**

Ashtu si edhe vitin e fundit, është shprehur shqetësim për rritjen e vazhdueshme të borxhit publik. **Këtë vit, Komisioni përcakton regres në disiplinën fiskale dhe menaxhimin e financave publike, veçanërisht në aspektin e transparencës.** Pothuajse gjysma e shpenzimeve publike ka qenë e projektuar për "transferta sociale, duke i përfshirë edhe pensionet të cilat Qeveria i ka rritur, por ashtu si edhe në vitin e kaluar, edhe pse ajo nuk është paraparë në ligj, pavarësisht uljes së çmimeve". Për këto arsye, tregohet nevoja për përmisimin e planifikimit afatmesëm të konsumit

Vlerësimet për situatën makroekonomike dhe politikën monetare janë pozitive, por potencohet nevoja për zhvillimin e mëtejshëm të sektorit privat që në masë të madhe është e kufizuar nga ekonomia gri.

Pengesat strukturore akoma janë të pranishme në tregun e punës. Niveli i lartë i papunësisë, pjesëmarrja e ulët e femrave në tregun e punës, masat e papërshtatshme aktive, si dhe krijimi i vendeve të reja të punës kryesisht në sektorët me produktivitet të ulët e kufizojnë progresin. Megjithatë, është spikatur një progres i caktuar në trajtimin me mangësitë në drejtim të kapitalit njerëzor dhe infrastrukturës fizike.

Është vërrejtur që ndryshimet e shpeshta ligjore, aplikimi i pabarabartë i ligjeve dhe zbatimi i vështirësuar i marrëveshjeve vazhdon t'i ngarkojë aktivitetet afariste.

Komisioni nxjerr në pah përmisimin e mjedisit afarist dhe përpjekjeve të vazhdueshme për të nxitur rritje dhe punësim përmes investimeve në infrastrukturën publike e investimet e huaja. **Megjithatë, statusi i ekonomisë funksionale akoma nuk i është dhënë Maqedonisë.** Këtë vit, Komisioni atë e sqaron me regres në disiplinën fiskale, zbatimin e dobët të marrëveshjeve dhe ekzistencën e një ekonomie voluminoze gri.

Risia metodologjike e këtij viti i referohet ndërlidhjes eksplicite të kësaj pjese të raportit me Programin për Reforma Ekonomike (PRE) dhe theksimit të rekomandimeve të dhëna sipas saj. PRE, si dokument i standardizuar i vendeve të standardizuara me procesin e zgjerimit krijon një politikë afatmesme makro-fiskale me rerforma kyçe strukturore që synojnë mbështetjen e të njëjtës, pro edhe rritjen e konkurrencës. Komisioni i përgatiti rekomandimet në bazë të PRE-së, dhe propozon marrjen e masave shtesë nga ana e Qeverisë për përmbushjen e të njëjtave.

## Aftësia për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit

Sa i përket aftësive për ti ndërmarrë përsipër detyrimet e anëtarësisë, shteti ka një **nivel relativisht të mirë të përgatitjes për të marrë detyrimet e anëtarisëmit**. Megjithatë, sipas vlerësimit tonë është 2.91 prej 5 të mundshme. Madje, krahasuar me vitet e kaluara, niveli i gatishmërisë/përputhshmërisë është më i vogël me vitet e mëparshme.

KE qëndron pas konstatimit të përsëritur që më parë, që vëmendje më e madhe duhet të vendoset mbi kapacitetin administrativ dhe zbatimin efektiv.

Në shumicën e fushave, në vlerësimet e reja të cilat jepen nga ana e Komisionit, shteti ka arritur një nivel të moderuar të gatishmërisë.

**Në mënyrë eksplicite theksohet që janë të nevojshme përpjekje të mëtejshme në ata kapituj ku shteti është në fazën e hershme të gatishmërisë**. Si kapituj të këtillë janë cekur vetëm dy, respektivisht **Lëvizja e Lirë e Punëtorëve** dhe **Dispozitat financiare dhe buxhetore**. Pozicioni i këtillë është i paarsyeshëm, sepse këta dy kapituj në praktikë harmonizohen në një fazë të mëvonshme të aderimit. **Karakteristike është që asnjë kapitull nuk është vlerësuar me nivel të lartë të pajtueshmërisë.**

**Vlerësimi për nivelin e tyre të pajtueshmërisë për vitin 2015 në bazë të kapitujve**

| Vlerësimi | |
|---|---|
| Fazën e hershme e përgatitjes - 1[6] – 1 | Lëvizja e Lirë e Punëtorëve; Dispozitat financiare dhe buxhetore |
| Niveli i caktuar i përgatitjes [7] – 2 | Siguria e Ushqimit, Politika Veterinare dhe Fitosanitare; Gjygjësori dhe të Drejtat themelore |
| Niveli i moderuar i përgatitjes[8] – 3 | Qarkullimi i Lirë i Mallrave; E Drejta e Themelimit dhe Liria e Sigurimit të Shërbimeve; Lëvizja e lirë e kapitalit; Prokurimi Publik; E drejta në pronësi intelektuale; Politika e konkurencës; Shërbimet financiare; Bujqësia dhe zhvillimi rural; Peshkimi; Politika e Komunikacionit; Energjia; Tatimet; Politika ekonomike dhe monetare; Statistika; Politika sociale dhe punësimi; Ndërmarrjet dhe politika industriale; Politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore; Drejtësia, liria dhe siguria; Arsimi dhe kultura; Mbrojtja e mjedisit; Mbrojtja e Konsumatorëve dhe mbrojtja e shëndetit; Marrëdhëniet e Jashtme; Politika e Jashtme, e Sigurisë dhe Mbrojtjes; Kontrolli financiar |
| Nivel i mirë i përgatitjes [9] – 4 | E drejta e Shoqërive Tregtare; Shoqëria Informatike dhe Mediat; Rrjete trans-evropiane; Shkenca dhe hulumtimi; Unioni Doganor; |
| Gatishmëri në nivel të lartë[10] – 5 | |

[6] Early stage of preparation
[7] Some level of preparation
[8] Moderately prepared
[9] Good level of preparation
[10] Well advanced

Lidhur me progresin e arritur brenda periudhës 12 mujore, si fusha ku **Komisioni shpreh kritikë më të madhe dhe thekson që nuk ka progres janë kapitujt e *Gjyqësorit dhe Të drejtat themelore dhe Politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore.***

**Në përputhje me këtë, analiza jonë shfaq që regres më i madh krahas viteve të fundit, si në aspekt të nivelit aktual të pajtueshmërisë me acquis, ashtu edhe në progresin që e ka arritur vendi në periudhën e 12 muajve të fundit, mund të vërrehet në dy kapitujt, Gjyqësori e të drejtat themelore dhe Drejtësia, liria e siguria.**

Tregues është edhe **rënia e vazhdueshme e progresit dhe nivelit të gatishmërisë në Kapitullin 31 - Siguria e Përbashkët dhe Politika e Jashtme**, ku në mënyrë të qartë shfaqet që Republika e Maqedonisë sa më pak i harmonizon pozitat e veta për politikë të jashtme me ata të BE-së..

**Derisa në raportin e vitit të kaluar numërohen kapitujt ku ka progres dhe kapitujt ku shfaqet nevoja për përmisime të mëtejshme, në këtë progres raport do të konstatohet në kapitujt të cilët janë të shtuara në bazat (fundalmentals) dhe do të ndiqen në mënyrë eksplicite me qasje të re.**

***Asnjë kapitull nuk është vlerësuar me nivel të lartë të gatishmërisë.***

### Krahasim me vitin 2014 në drejtim të progresit dhe përputhshmërisë

Në krahasim me vlerësimet e Raportit të Progresit të vitit 2014, dallime ka në aspekt të vlerësimeve për progresin edhe për përputhshmërinë.

Në aspekt të progresit, **vlerësime më të larta** në krahasim me vitin 2014 kanë kapitujt:E drejta e themelimit dhe liria për sigurimin e shërbimeve; Qarkullimi i Lirë i Kapitalit; Politika ekonomike dhe monetare; Politika shoqërore dhe punësimi; Rrjetet trans-evropiane; Unioni Doganor; Marrëdhëniet me Jashtë; Politika e Jashtme, e Sigurisë dhe Mbrojtjes e Dispozitat financiare dhe buxhetore.

Vlerësim më të ulët në progres në krahasim me Raportin e Progresit të vitit 2014, ka në kapitujt: Prokurimi Publik; E drejta e Shoqërive Tregtare; Politika e konkurrencës; Shoqëria Informatike dhe Mediat; Siguria e Ushqimit, Politika Veterinare dhe Fitosanitare; Statistika; Politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore; Jurisprudenca dhe të Drejtat Fundamentale; Drejtësia, liria dhe siguria.

**Gatishmëria për marrje përsipër të detyrimeve të anëtarësimit** / Përputhja me acquis të BE-së është e vlerësuar më lartë në krahasim me Raportin e Progresit të vitit 2014 në kapitujt: Shoqëria Informatike dhe Mediat; Politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore dhe Shkenca e Hulumtimi.

**Me nivel më të ulët është vlerësuar** në drejtim të kapitujve: Qarkullimi i Lirë i Mallrave; Prokurime Publike; Politika e konkurrencës; Siguria e Ushqimit, Politika Veterinare dhe Fitosanitare;Peshkimi; Politika ekonomike dhe monetare, Statistika dhe Drejtësia, liria e siguria

## Shtojca 1: Struktura e kritereve politike në raportin për vitin

2. Kriteret Politike

2.1 Demokracia

Zgjedhjet

Parlamenti

Qeverisja

Shoqëria civile

Mbikëqyrja mbi shërbimet e inteligjencës (Kapitulli 24 - Drejtësia, Liria dhe Siguria)

2.2 Reforma e Administratës Publike

2.3 Sundimi i së drejtës

Funksionimi i gjyqësorit (Kapitulli 23 - Gjygjësori dhe të drejtat themelore)

Lufta kundër korrupsionit (Kapitulli 24 - Drejtësia, Liria dhe Siguria)

Lufta kundër krimit të organizuar (Kapitulli 24 - Drejtësia, Liria dhe Siguria)

Lufta kundër terrorizmit (Kapitulli 24 - Drejtësia, Liria dhe Siguria)

2.4 Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e komuniteteve pakicë

Liria e shprehjes

2.5 Çështjet rajonale dhe obligimet ndërkombëtare

## Shtojca 2: Shqyrtimi i rekomandimeve të kritereve politike për vitin 2015-2016

### *2.1 Demokracia*

***Zgjedhjet***

- *Zbatimi i plotë i rekomandimeve të OSBE-së/ODIHR-it para mbajtjes së zgjedhjeve të ardhshme*

**Parlament**

- *Zbatimi i rekomandimeve të Komisionit Hetimor për ngjarjet e ndërlidhura me 24 dhjetor 2012*

**Qeverisje**

- *Të gjithë rregullatorët e pavarur, mbikëqyrësit dhe organet këshilluese duhet të jenë në mundësi t'i shfrytëzojnë autorizimet e tyre në mënyrë proaktive dhe efektive, pa presion të jashtëm e pa shfrytëzim të papërshtatshëm politik vetë-kufizues ose interpretim të mandateve të tyre në formë zyrtare. Këta organe përfshijnë: Komisionin shtetëror të zgjedhjeve, Komisionin shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Agjencisë për audio dhe shërbime audio-vizuale, Avokatin e Popullit, Këshillin Gjyqësor, Këshillin e prokurorëve publikë dhe Revizori Shtetëror.*
- ***Mbikëqyrja e shërbimeve të inteligjencës,***
- *Të gjitha rekomandimet e prioriteteve urgjente të reformave për mbikëqyrje dhe reforma.*

### *2.2. Reforma e Administratës Publike*

- *ta adresojë shqetësimin serioz për politizimin e shërbimit publik, zbatimin e plotë të parimeve të përgjegjësisë, transparencës dhe meritës, duke e përfshirë zbatimin e një sistemi të përmisuar, sistem informacioni për menaxhimin me burimet njerëzore.*
- *Pezullimi dhe rishikimi i Ligjit për transformimin e kontratave të përkohshme në të përhershme, derisa parimi meritor nuk është plotësisht i përfshirë.*
- *Miratimi i strategjisë për administratën publike dhe menaxhimin me financat publike, me çka duhet të adresohen dobësitë e identifikuara, duke përfshirë edhe transparencën buxhetore.*

### *2.3 Sundimi i së drejtës*

**Gjyqësori**

- *Depolitizimi i sistemit të emërimit dhe përparimit në praktikë, jo vetëm në ligj;*
- *sigurimi I plotë për mbështjetje dhe burime për punën e prokurores speciale publike;*
- *Reformimi i sistemit ekzistues në masa disiplinore dhe shkarkimi i gjyqtarëve;*
- *Miratimi i strategjisë së re për reforma në gjyqësor dhe plan veprimi me qëllim për t'i adresuar mangësitë e mbetura në mënyrë të qëndrueshme;*
- *përmisimi i planifikimit strategjik, vlerësimi i nevojave, menaxhimit dhe alokimi i resurseve brenda suazave të gjyqësorit.*

**Lufta kundër korrupsionit**

- *demonstrimi i vullnetit të vërtetë politik për luftë kundrejt korrupsionit në formë të ndërmarrjes së masave të pavarura dhe efektive nga ana e organeve për zbatimin e ligjit dhe organeve mbikëqyrëse, në veçanti Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit;*
- *rritja e vizibilitetit të masave të anti-korrupsionit dhe rezultatet e arritura me qëllim për të përmisuar ndërgjegjësimin e opinionit dhe besimin;*

- *zhvillimi i dosjes së besueshmërisë të situatës në drejtim të korrupsionit të lartë;*
- *krijimi i një kuadri efektiv për mbrojtjen e treguesëve, në përputhje me standardet evropiane dhe praktikat më të mira.*

**Lufta kundër krimit të organizuar**

- *Rivendosja e dosjes për luftë kundër larjes së parave dhe avancimi i kapaciteteve dhe ekspertizave për kryerjen e hetimeve financiare dhe konfiskimin e aseteve në bazë më sistematike;*
- *Përforcim i përpjekjeve për të përmirësuar bashkëpunimin ndërmjet agjencive të ndryshme për zbatimin e ligjit përmes trajnimeve të plota të Qendrës Kombëtare të Koordinimit për Luftë Kundër Krimit të Organizuar;*
- *Rishikimi i kuadrit ligjor dhe teknik për ndjekjen e komunikimeve dhe rritjen e efektivitetit të masave të posaçme hetimore për zbatimin vërtetë e objektivave ligjore (prioritetet urgjente të reformave ).*

**2.4. Të drejtat e njeriut**

**Liria e shprehjes**

- *Sigurimi i transparencës së plotë mbi reklamat qeveritare dhe zhvillimi i mekanizmave për njoftime të papaguara të shërbimeve publike që janë me interes të mirëfilltë publik.*
- *Garantimi dhe zbatimi i praktikës së vetë-limitimit përkatës në nivel politik nga ana e politikanëve dhe zyrtarëve publik që të mos ngritet procedurë për shpifje, në përputhje me principet e GJEDNJ.*
- *Sigurim i qasjes ndaj opinionit mbi raportim objektiv dhe të saktë për mendime të ndryshme në mediat e shikuara, doemos në shërbimin publik të radiodifuzionit.*

**Shtojca 3: Përmbledhje e përfundimeve dhe vlerësimeve në kriteret politike 2011-2015**

| Kriteri/ Nënkriteri/ Kapitulli | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 |
|---|---|---|---|---|---|
| ***I.1.1. Demokracia dhe sundimi i së drejtës*** | | | | | 2.1 Demokracia<br><br>Vendi u ballafaqua me krizën më të rrëndë politike që nga viti 2001, kriza u thellua edhe më shumë me publikim e bisedave të përgjuara përfshirë edhe bartës të funksioneve të larta në qeveri të cilët sygjerojnë dëmtim të të drejtave fundamentale, ndikim mbi pavarësinë e gjyqësorit, lirinë e mediave e zgjedhjeve, politizim dhe korpupsion në fusha të ndryshme. Shqetësimet lidhur me të gjitha këto çështje qenë të sinjalizuara në raportet e mëparshme të progresit. Si përgjegje e kësaj, Komisioni i publikoi prioritetet urgjente të reformave që pjesërisht bazohen në rekomandimet e mëparshme dhe pjesërisht në rekomandimet nga Grupa të ekspertëve të nivelit të lartë për sundimin e së drejtës. Komisioneri, me ndihmën e tre |

| **Kriteri/ Nënkriteri/ Kapitulli** | **2011** | | **2012** | | **2013** | **2014** | **2015** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | pjesëtarëve tjerë të Parlamentit Evropian, e lehtësonte marrëveshjen politke të periudhës qershor/korrik. Deri tani, jo të gjitha elementet e marrëveshjes janë zbatuar dhe një numër i madh i afateve kanë skaduar - janë shtyrë - пробиени.<br>Liderët e partive politike janë të përkushtuar që ti zbatojnë të gjitha rekomandimet nga Komisioni për çështjet sistematike lidhur me sundimin e së drejtës (prioritetet urgjente të reformave), megjithatë, zbatimi filloi me një ritëm të ngadalshëm, pa rezultate konkrete deri më sot. |
| ***Kushtetuta*** | | | | | Kushtetuta:<br>– nevojitet avancim cilësor i legjislacionit;<br>– të dhënat e Komisionit të Venecias për Lustrim: aplikim i masave të | Amendamentet kushtetuese ishin pa legjislacion shoqërues për implementimin e tyre.<br>Duhet të bazohen mbi konsensus të gjerë. BE bën analiza plotësuese të harmonizimit të | Qenë të propozuara amandamentet kushtetuese nga ana e Qeverisë për një gamë të gjërë fushash, pavarësisht mungesës së partisë kryesore opozitare në Parlament.<br>Asnjë nga ndryshimet e propozuara dhe asnjë nga legjislacionet shoqëruese nuk qenë të miratuara nga ana e Parlamentit si pasojë e asaj që nuk mund të arrihej dy e treta e shumicës. |

| Kriteri/ Nënkriteri/ Kapitulli | 2011 | | 2012 | | 2013 | 2014 | 2015 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | lustrimit për një kohë të gjatë pas fillimit të demokratizimit, keqpërdorim i shkaqeve politike, ideologjike dhe partiake për masat e lustrimit | legjislacionit me atë të BE. Kohëve të fundit është vënë në pikëpyetje pavarësia e Gjykatës Kushtetuese. | |
| Zgjedhjet | Progres në zbatimin e zgjedhjeve. Zgjedhjet ishin kompetitive, transparente dhe mirë të administr | 3 | Legjislacioni është dërguar për shqyrtim në Kuvend | 3 | Sipas OSBE-së zgjedhjet lokale u administruan në mënyrë efikase, por me tendencë të frikësimit të votuesve dhe keqpërdorimit të mjeteve shtetërore në fushatë. Vazhdon puna e grupeve të punës për rekomandimet e mbetura të OSBE-së | Sipas OSBE/ODIHR–së, zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare u administruan mirë, pa u penguar e drejta e tubimit. Vërehet distancimi i paqartë midis shtetit dhe partisë. Sugjerohet mjedisi i pabarabartë për garë politike ndërmjet kandidatëve politikë. | Mangësitë e ndërlidhura me zgjedhjet, paraprakisht të sinjalizuara nga OSBE/ODIHR dhe dyshime të tjera, qenë të reflektuara në përmbajtjen e bisedave të përgjuara. Prioritetet urgjente të reformave duhet të zbatohen. |

| Kriteri/ Nënkriteri/ Kapitulli | 2011 | | 2012 | | 2013 | 2014 | 2015 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | uara në mbarë vendin. | | | | për legjislacionin zgjedhor dhe Listën e Zgjedhësve. | Përsëritet shqetësimi për frikësimin e votuesve. Kritika mbi mediat dhe mënyrës së raportimit dhe mospasje e dallimit të qartë midis aktiviteteve të përfaqësuesve të pushtetit dhe kandidatëve politikë në zgjedhje. KSHZ-ja është vlerësuar mirë për administrimin e zgjedhjeve. Dy grupet e punës gjatë verës vazhduan me punë për adresimin e rekomandimeve nga OSBE/ODIHR. | |
| Dialogu politik | Progres i caktuar | 2 | [11] | | [12] | Përgjegjësia bie mbi Qeverinë dhe opozitën sa i përket sigurimit të debatit politik në Kuvend | Ndërprerja e dialogut politik dhe vështirësitë që të arrihet konsensus për çështjet edhe njëherë e |

[11] Не е посебно издвоен во овој дел во овој Извештај, политичкиот дијалог се третира во рамките на Собранието.
[12] Не е посебно издвоен во овој дел во овој Извештај, политичкиот дијалог се третира во рамките на Собранието.

| Kriteri/ Nënkriteri/ Kapitulli | 2011 | | 2012 | | 2013 | 2014 | 2015 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | dhe sigurimit të kushteve për funksionimin e tyre. | potencuan kulturën përçarëse në vend. |
